



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM
Nr. 45 datë 31.07.2024**

“PËR DHËNIE PËLQIMI PËR PRANIMIN E DONACIONIT NGA WORLD VISION ALBANIA, NË CILËSINË E DONATORIT PËR INVESTIMIN DHE ZBATIMIN E PROJEKTIT “KËND LOJRASH”.

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 31.07.2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 9, pika 1.2 shkronja a) dhe c), nenit 24, të ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Ligjit Nr.121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, ligjit Nr.10296, datë 08.07.2014 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, nenit 20 pika 3 të ligjit Nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, VKM Nr.366 datë 27.03.2008 “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose përdorim të Bashkisë Shkodër”, Udhëzimit Nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të ndryshuar si dhe dokumentacionin e përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër,

VENDOSI:

1. Miratimin e dhënies së pëlqimit për pranimin e donacionit nga World Vision Albania, në cilësinë e donatorit për investimin dhe zbatimin e projektit “Kënd lojrash”, sipas draft marrëveshjes bashkëngjitur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

Miratuar me 25 vota
Vota Pro 25
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 1
Zbardhur me datë 01.08.2024



KRYETAR

Oltion LULI

SEKRETARE

Sabina Danaj